

## Performanca e Buxhetit 2018



### NË KËTË RAPORT

**Periudha raportimit:** Janar - Dhjetor 2018

**Statusi raportit:** Raporti bazohet në të dhëna të konsoliduara të zbatimit të buxhetit për bashkinë Korçë gjatë vitit 2018 dhe është miratuar në Këshillin Bashkiak

*Përmbledhje mbi situatën financiare, të ardhurat, shpenzimet sipas programeve si edhe rezultatet kryesore të ekzekutimit të buxhetit për vitin 2018*

*Ky raport është përgatitur nga Bashkia Korçë me asistencën e Projektit "Bashki të Forta".*

*Për më shumë informacion në lidhje me të kontaktoni me Valbona Ziko*

*në adresën: [valbonaziko@yahoo.com](mailto:valbonaziko@yahoo.com)*

# TË DHËNA TË PËRGJITHSHME



Popullsia: Censuri (2011) 75.994 banorë  
Rregjistri Civil 129.065 banorë  
Siperfaqja: 805.99 km<sup>2</sup>  
Dendësia: Censuri (2011) 94,2 banorë/km<sup>2</sup>  
Rregjistri Civil 160.1 banorë/km<sup>2</sup>

Nëndarjet Administrative: 8

(1) Korçë (2) Qendër Bulgarec (3) Voskop (4) Voskopojë (5) Lekas (6) Vithkuq (7) Mollaj (8) Drenovë

## Rezultatet në zgjedhjet vendore të vitit 2015 si më poshtë:



## Shpërndarja e anëtarëve:

17 Anëtarë  
11 Anëtarë  
8 Anëtarë  
1 Anëtarë  
1 Anëtarë  
1 Anëtarë  
1 Anëtarë  
1 Anëtarë

**EKZEKUTIVI** Numri i përgjithshëm i zgjedhësve të regjistruar në Bashkinë Korçë për zgjedhjet vendore të vitit 2015 ishte 106.524 persona. Pjesëmarrja e votuesve në zgjedhjet e fundit lokale ishte 42%. Këshilli bashkiak përbëhet nga 41 anëtarë të grupuar midis partive politike PS, PD, LSI, PR PGJ, FRD, AAK dhe PDS. Kryetari i Bashkisë është **Z. Sotiraq FILO**. Bashkia është e organizuar në 14 drejtori si: ekonomi dhe financë; buxheti, tatim taksa vendore, politikat e zhvillimit, shërbimet publike, bujqësia dhe pyjet, shërbimet sociale, planifikim dhe kontrolli i teritorrit, policia bashkiake, mbrojtja e territorit, ligjore, administratë dhe burimet njerëzore, arsim dhe edukim.


**EKONOMIA** Bashkisë së Korçës iu bashkëngjitën disa zona rurale të cilat merren me bujqësi dhe blegtori, por edhe disa prej fshatrave turistike më të spikatur. Qyteti ka një ekonomi të konsoliduar dhe biznese të shumta. Në zonat rurale janë zhvilluar nga njëra anë bujqësia dhe pemëtaria, dhe nga ana tjetër turizmi malor ku banorët kanë vetësiguruar mënyrën e organizimit të ambienteve dhe kuzhinës por edhe aktiviteteve dimërore si një atraksion për turistët. Përgjatë viteve të fundit Korça ka synuar dhe ka arritur të shumëfishojë shifrat e turistëve përmes një kalendari të mbushur me festa përgjatë verës. Aktivitetet e shumta të cilat mbështeten kryesisht tek traditat e zonës dhe promovimi i tyre, por edhe aktivitete të tjera të cilat sjellin aktivitete kulturore, kanë bërë që në stinën e verës kjo zonë të ketë interes nga vizitorë të shumtë.

# SITUATA FINANCIARE

- ⇒ Rritja e financimit të shërbimeve publike nga burimet e brendshme të bashkisë prej të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore pa rritur barrën fiskale.
- ⇒ Të ardhurat e veta të bashkisë zënë një peshë edhe më të madhe në burimet e bashkisë duke e rritur kontributin e tyre në tërësinë e fondeve buxhetore të bashkisë me 31%, si rrjedhojë e taksave dhe tarifave vendore në rritje (më shumë se dyfish rritje kundrejt një viti më parë).
- ⇒ Përmirësim i menaxhimit buxhetor dhe qëndrueshmëri financiare duke kryer shpenzime buxhetore brenda burimeve të të ardhurave të mbledhura
- ⇒ Menaxhim i kujdesshëm i fondeve të bashkisë duke kryer shpenzime 100% në nivelin e burimeve financiare.

Fakt 2016, 2017, 2018

Figura 1: Treguesit financiare te bashkise Korce, periudha 2016-2018, ne %



Burimi i Informacionit  
"Raporti i Monitorimit 2018 - Bashkia Korce"

2017 Vs 2018

Figura 2: Ecuria e treguesve financiare te bashkise Korce, 2017-2018, ne %



Burimi i Informacionit  
"Raporti i Monitorimit 2018 - Bashkia Korce"

# SHERBIMET DHE TE ARDHURAT 2018

## Burimet e financimit (Buxheti i rishikuar) 2018

- ⇒ Transferta e pakushtëzuar (granti), në vlerën 419.527 mijë lekë;
- ⇒ Transferta specifike, e cila është në vlerën 302.498 mijë lekë;
- ⇒ Të ardhurat nga burimet e veta, në vlerën 981,653 mijë lekë;
- ⇒ Të ardhura të trashëguara nga viti 2017, në shumën 373.772 mijë lekë;
- ⇒ Transfertat e kushtëzuara në vlerën 1.081.210 mijë lekë;
- ⇒ Të tjera 2,741 mijë lekë

**Buxheti për vitin 2018 = 3,161,401**  
**mijë lekë**

## Shërbimet kryesore të ofruara dhe financuara nga bashkia janë


- ⇒ Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi
- ⇒ Pastrim, gjelbërim , ndriçim
- ⇒ Menaxhimi rrugor dhe transporti publik
- ⇒ Menaxhimi rrugor FZHR
- ⇒ Zhvillimi i Sportit
- ⇒ Programi i Kulturës
- ⇒ Kujdesi social
- ⇒ Arsimi parashkollor
- ⇒ Arsimi parauniversitar
- ⇒ Mbrojtja nga zjarri dhe emergjencat civile
- ⇒ Ujitja dhe kullimi
- ⇒ Administrimi i pyjeve



# TE ARDHURAT 2018

**Figura 3:**

**Të ardhurat nga burimet e Vetë bashkisë  
2016-2018 në mijë Lekë**




Burimi: Buxheti konsoliduar 2018 Bashkia Korçë



**Figura 4:**

**Burimet e financimit të bashkisë  
2016-2018 në mijë Lekë**




Burimi: Buxheti konsoliduar 2018 Bashkia Korçë

# SHPENZIMET

Bashkia Korçë i kushton vëmendje gjithnjë e më shumë vëmendje infrastrukturës. Programet buxhetore më të financuara gjatë vitit 2018, që përbëjnë rreth 91% të buxhetit janë:

- A. Menaxhim i rrugëve nga FZHR dhe vetë bashkia
- B. Planifikim, Menaxhim, Administrim
- C. Pastrim, gjelbërim, ndriçim
- D. Arsimin (parashkollor dhe ai parauniversitar
- E. Programi i Kulturës

Shpenzime sipas programeve, % ndaj totalit të Buxhetit, 2018



*Programet me ekzekutim me të lartë janë Menaxhimi Rrugor dhe Transporti Publik, kurse Ujitje dhe Kullimi ka ekzekutimin me të vogël*

Figura 3: Shpenzimet sipas programeve buxhetore të bashkisë Korçë, 2018, fakt kundrejt plan në Leke



Bashkia e Korçës,  
Raporti i Monitorimit vitit 2018,  
Bashkia e Korçës

# SHPENZIMET

Të ndara sipas aktivitetit ekonomik, shpenzimet kapitale perbejne 38% te totalit te shpenzimeve kurse ato operative 62%. Në grafik paraqitet perqindja e realizimit ndaj planifikimit, ndërsa tabela me poshtë liston investimet më të rëndësishme të bashkisë.

## Shpenzimet sipas Klasifikimit Ekonomik në Lekë

### Shpenzime



Bazimi i informacionit:  
Raporti Monitorimi 2018  
Bashkia e Korçës

## Projektet e Investimeve në Lekë

Emertimi i projektit	Filipe	Mbase	Realizimi (Lekë)	% Realizimit
Blerje ndihmueshke qytet dhe NJM	2018	2018	30,080,000	9.94%
Investime në shërbime e pyesje dhe kullotase ne 3 vite	2016	2018	5,150,000	15.90%
Rehabilitimi urban i territorit prapa teatrit AZÇajupi	2017	2018	6,682,000	100.00%
Rikonstruksion i Teatrit "A.Z Çajupi" faza e dyte	2017	2018	187,797,000	100.00%
Rikonstruksion kopshti nr. 9	2018	2018	6,080,000	0.00%
Rikonstruksion i froyer Frate-Ponice	2017	2018	23,361,000	31.43%
Rrethim varesa	2018	2018	6,798,000	100.00%
Rrugi meza parcelave	2018	2018	4,838,800	100.00%
Shtetësiu asfaltim ne rrugjet e NIA (Nisatrat Belgarec, Porodine, Binas), Gostiva poshte dhe RL	2018	2019	41,083,000	24.11%
Shtetësiu asfaltim ne rrugjet e qytetit (lagjet 4,5,6,8,10 dhe 18)	2018	2019	46,039,000	29.22%
Shtetësiu, ngroqje për dhomat e zhvieshjes (Rekualifikimi urban i zones pjemtohe Qyteza st Fera	2018	2018	5,793,800	97.57%

Bazimi i informacionit:  
Raporti Monitorimi 2018  
Bashkia e Korçës

# OBJEKTIVAT E BUXHETIT 2018

- ◆ Ofrimi i shërbimeve cilësore për komunitetin
- ◆ Rehabilitimi i infrastrukturës në zonat ku ka zhvillime të reja urbane
  - ◆ Shtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve dhe hapësirave publike
    - ◆ Përmirësimi i hapësirave rikrijuese publike
  - ◆ Përmirësimi i infrastrukturës së institucioneve arsimore publike
- ◆ Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore
- ◆ Vënia në funksionim i Qendrës Multifunktionale sportive kulturore
  - ◆ Rritja e aktiviteteve sportive me mbështetjen e bashkisë
    - ◆ Mbrojtja e jetës dhe pronës nga zjarri
  - ◆ Administrimi i kujdesshëm i fondit pyjor dhe kullosor
    - ◆ Mbrojtja e tokave bujqësore
  - ◆ Rehabilitimi dhe rikonstruksioni i veprave ujitëse.



# TREGUESIT E PERFORMANCES

Rezultatet vjetore të treguesve të performancës buxhetore



Bashkia ka rritur performancën e përdorimit të fondeve buxhetore. Kjo rritje ka ardhur edhe në sajë të rritjes së transparencës së vendimarrjes bashkiake.

Të gjitha mbledhjet e Këshillit Bashkiak kanë qenë të hapura dhe pjesa më e madhe e vendimeve që detyrojnë konsultimin me publikun janë diskutuar paraprakisht me banorët.

Disa arritje të rëndësishme të përmirësimit të shërbimeve ofruar komunitetit vendor falë rritjes jo vetëm të burimeve financiare, por edhe të kapaciteteve njerëzore të bashkisë janë renditur më poshtë nëpërmjet treguesve të performancës sipas programeve.

# PROGRAM

## PLANIFIKIM, MENAXHIM DHE ADMINISTRIM

### OBJEKTIVA

#### (A) Menaxhim i kujdesshëm i financave vendore

Bashkia synon moskrijimin e borxheve

#### (B) Rritja e ekonomisë vendore

Bashkia synon që nëpërmjet procedurave lehtësuese në komunikim me biznesin vendor të krijojë kushte për rritjen e të

#### (C) Përmirësimi i punës së administratës në ndihmë të komunitetit

Bashkia synon zgjidhjen e ankesave të qytetarëve dhe fitimi i çështjeve gjyqësore

### TREGUES performance

#### TP 1. Likuidimi i kredise sipas planit te pagesave

Bashkia ka marrë një kredi tregtare në vitin 2010 për të financuar projektet e investimeve të bashkisë Korçë. Bashkia në bazë të kushteve të kontratës ka respektuar të gjitha detyrimet në kohë.

#### TP 2. Mbledhja e borxhit te krijuar 2011-2017

Bashkia e re pas reformës administrative ka trashëguar borxhin e akumuluar nga ish Komunat që iu bashkëngjitën bashkisë në vitin 2015. Gjatë vitit 2018 Bashkia ka arritur të mbledhë rreth 16% të borxhit të akumuluar nga të tretët.

#### TP 1. Rritja e numrit të bizneseve (trendi vjetor në %)

Bashkia kishte parashikuar se numri i bizneseve të reja të regjistruar përgjatë gjithë vitit 2018 do të rritej me 5%, ndërkohë që shifrat faktike tregojnë se numri i bizneseve të regjistruar është rritur me 16% duke e çuar numrin e bizneseve aktiv të regjistruar në territorin e bashkisë nga 3,262 në 3,784 biznese në fund të vitit 2018.

#### TP 1. Hapja e sporteleve të reja (realizimi vjetor në %)

Bashkia kishte planifikuar të hapte sportele të reja për të krijuar lehtësira në pritjen e qytatëve gjatë vitit 2018, objektiv të cilin e ka realizuar tërësisht. Numri i qytetarëve që i drejtohen sporteleve të bashkisë dhe gjejnë zgjidhje të ankesave / problemeve që ata hasin është rritur.

#### TP 2. Raste gjyqësore të fituara (Raporte raste të fituara

Bashkia ka 83 çështje të cilat i janë drejtuar gjykatës për zgjidhje si palë paditëse apo e paditur nga të tretët. Gjatë vitit 2018 Bashkia ka ndjekur për zgjidhje 29 çështje, duke i dhënë zgjidhje rreth 35% të çështjeve gjyqësore

# PROGRAMI

## SHËRBIMI I PASTRIMIT, GJELBËRIMIT DHE NDRIÇIMIT

### OBJEKTIVI

Përmirësimi i hapësirave publike për një jetesë më të mirë të komunitit

**Realizimi i shpenzimeve :**  
76% e vlerës së parashikuar  
324.513 mijë lekë, 17% e buxhetit



### TREGUES performance

#### TP 1. Shtimi i elementëve plotësues të lulishteve

Janë vendosur 101 stola dhe 7 kosha të rinj në lulishtet e qytetit duke realizuar planin e këtyre elementëve të rinj me 82%


#### TP 2. Vendosja e sistemit vaditës në sipërfaqet e reja

Për të siguruar gjelbërim për bimësinë dekorative të hapësirave publike dhe lulishteve të qytetit bashkia ka investuar në vendosjen e sistemit vaditës në sipërfaqet e shtuara publike. Gjatë vitit 2018 bashkia arriti të mbulojë rreth 20 mijë metra katrorë me sistem vaditës gjë që përbën rreth 93% të planit.

#### TP 3. Shtimi i sipërfaqeve të gjelbëra

Bashkia ka shtuar sipërfaqet e gjelbëra publike me mbi 13 mijë metra katrorë vetëm gjatë vitit 2018 duke e plotësuar planin me rreth 95%.

Pastrim, Gjelbërim, Ndriçim  
Plan vs Fakt 2018 (në 000 Lekë)



# PROGRAMI

## MENAXHIMI RRUGOR DHE TRANSPORTI PUBLIK

### TREGUES performance

#### OBJEKTIVI

Rritja e lëvizshmërisë së mjeteve dhe komunitetit

**Realizimi i shpenzimeve :**  
44% e vlerës së parashikuar  
120,277 mijë lekë, 6% e buxhetit


#### TP 1. Rehabilitimi i infrastrukturës në zonat e reja urbane

Gjatë vitit 2018 ka pasur disa ndërhyrje në rrugët dhe lagjet e qytetit që përfaqësojnë zona të reja të zhvillimit urban të komunitetit. Vlera e investimeve e realizuar në këto projekte të rehabilitimit të infrastrukturës është rreth 60% e planit

#### TP 2. Ndërtimi i terminalit të autobuzëve

Qytetit i mungon një terminal autobuzësh i cili jo vetëm rregullon qarkullimin në qytet por edhe përqëndron linjat inter-urbane duke krijuar mundësi për koordinim linjash dhe oraresh. Në përputhje me planin urban të qytetit bashkia nisi investimet për ndërtimin e terminalit të autobuzëve. Deri në fund të vitit 2018 bashkia ka investuar rreth 40% të vlerës së

Menaxhim Rrugor+Transporti Publik  
Plan vs Fakt 2018 (në 000 Lekë)



# PROGRAMI

## MENAXHIMI RRUGOR FZHR

### OBJEKTIVI

Rritja e lëvizshmërisë  
së mjeteve dhe  
komunitetit

**Realizimi i shpenzimeve :**  
89% e vlerës së parashikuar  
433,004 mijë lekë, 23% e bux-


### TREGUES performance

#### TP 1. Thithja e financimeve nga burime të tjera

Bashkia mundohet të thithë financime për përmirësimin e infrastrukturës nga burime të ndryshme përveç fondeve të saj nga taksat, tarifat dhe të ardhurat jotatimore.

Fondi Zhvillimit Shqiptar është një burim i rëndësishëm financiar për të arritur objektivat ambiciozë të bashkisë.

Gjatë vitit 2018 bashkia ka marrë prej fondit shpenzime në mbi 433 milionë lekë që përfaqësojnë 23% të buxhetit të bashkisë. Puna e mirë e bashkisë ka mundësuar që investimet e parashikuara të realizohen në masën 89% kundrejt planit.



# PROGRAMI

## ZHVILLIMI I SPORTEVE

### OBJEKTIVI

Nxitja, zhvillimi dhe përhapja e kulturës sportive në komunitetin

**Realizimi i shpenzimeve :**  
92% e vlerës së parashikuar  
37,759 mijë lekë, 2% e buxhetit

### TREGUES performance


#### TP 1. Ngritja e Qendrës Multifunkionale

Gjatë vitit 2018 bashkia arriti jo vetëm të përfundojë por edhe të vërë në funksionim të qendrës multifunkionale sportivo-kulturore, duke mundësuar kështu që gjatë viteve të ardhshme të rritet numri i aktiviteteve sportive dhe artistike që do të organizojë apo mbështesë bashkia.

#### TP 2. Shtimi i aktiviteteve sportive

Bashkia ka gjallëruar jetën sportive të qytetit duke ofruar aktivitete të cilat nuk kanë qënë organizuar më parë. Kështu është rritur numri i projekteve të Bashkisë në fushën e sportit si ciklizmi; badminton, zhvillimi i kampionateve kombëtare të volejbollit, basketbollit, atletikë për femra dhe meshkuj, aktiviteti Korca open air etj. Gjatë vitit 2018 bashkia ka realizuar 93%

Zhvillimi i Sportit  
Plan vs Fakt 2018 (në 000 Lekë)



# PROGRAMI

## KULTURA

### OBJEKTIVI

Krijimi i një jete të pasur kulturore dhe sociale

**Realizimi i shpenzimeve :**  
87% e vlerës së parashikuar  
145,522 mijë lekë, 8% e buxhetit

### TREGUES performance


TP 1. Rritja e eventeve kulturore mbështetur nga bashkia

Gjatë vitit 2018 bashkia arriti jo vetëm të përfundojë por edhe të vërë në funksionim qendrën multifunksionale sportivo-kulturore, duke mundësuar kështu që gjatë viteve të ardhshme të rritet numri i aktiviteteve sportive dhe artistike që do të organizojë apo mbështesë bashkia.

Gjatë vitit 2018 është rritur financimi i aktiviteteve kulturore krahasuar me një vit më parë. Arritën të realizohen rreth 23 koncerte, festivale, opera dhe balet, 11 aktivitete të ndryshme, 6 aktivitete të organizuara nga biblioteka dhe 9 shfaqje teatrale duke realizuar rreth 98% të aktiviteteve të parashikuara.



Programi i Kulturës  
Plan vs Fakt 2018 (në 000 Lekë)




# PROGRAMI

## KUJDESI SOCIAL

### OBJEKTIVI

Përmirësimi i mbështetjes sociale të shtresave në nevojë

**Realizimi i shpenzimeve :**  
87% e vlerës së parashikuar  
5,492 mijë lekë



### TREGUES performance

#### TP 1. Menaxhimi i banesave sociale

Gjatë vitit 2018 bashkia i ka dhënë prioritet strehimit të familjeve në nevojë ku prioritet kanë pasur grate dhe kryefamiljaret viktime të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Bashkia ka akomoduar 100% të rasteve të tilla në aplikimet për *banesa sociale*.

Të ardhurat nga mirëadministrimi i banesave sociale (qiraja nga banesat sociale apo disbursimi i kredisë së butë për strehim) janë arkëtuar 100% sipas planit.

#### TP 2. Shërbime sociale për moshat e treta

Gjatë vitit 2018 është përmirësuar shërbimi ndaj moshave të treta i cili ofrohet në qendra ditore dhe rezidenciale rishtazi të ndërtuara dhe administruar nga bashkia, ku numri i punonjësve që shërbejnë është më i lartë për përfituesit. Bashkia ka rritur edhe shërbimin në shtëpi për të moshuarit e vetmuar.

#### TP 3. Shërbime sociale për fëmijët në nevojë

Gjatë vitit 2018 bashkia arriti jo vetëm të përfundojë por edhe të vërë në funksionim të qendrës multifunkionale. Në këtë qendër u ofrohet shërbim fëmijëve në gjendje rruge apo të familjeve në nevojë. Bashkia ka realizuar 100% planin e shërbimeve për këtë kategori.

#### TP 4. Mbështetja dhe fuqizimi i familjeve në nevojë

Nëpërmjet fondit të ndihmës ekonomike bashkia mbështet familjet në nevojë. Përveç fondit të dhënë nga qeveria qendrore në bazë të aplikimeve dhe verifikimit të rasteve bashkia mbështet nëpërmjet fondeve të saj familjet në nevojë. Bashkia gjatë vitit 2018 ka ofruar bazë materiale për raste emergjente. Plani u realizua 75%.




# PROGRAMI

## ARSIMI PARASHKOLLOR

### OBJEKTIVI

Përmirësimi i infrastrukturës në institucionet e arsimit parashkollor

**Realizimi i shpenzimeve :**  
83% e vlerës së parashikuar  
270,000 mijë lekë



### TREGUES performance

#### TP 1. Rritja e efikasitetit të fondeve buxhetore

Bashkia ka përmirësuar menaxhimin e fondeve të këtij programi buxhetor duke realizuar planin me 80%.

Me më pak fonde sesa parashikimi është përmirësuar cilësia e shërbimeve në pastrim, riparimin e difekteve të institucioneve parashkollore si edhe në sistemin elektrik, hidraulik, punime me dru, meremete të ndërtesave dhe rikonstrukcion të godinave të tyre.

#### TP 2. Përmirësimi i ngrohjes së godinave të arsimit

Ngrohja në objektet arsimore është kryer me dru, naftë dhe gaz i lëngshëm, në vlerën rreth 23 milionë lekë. Rritja e fokusit të bashkisë në përmirësimin e këtij treguesi ka bërë që bashkia të rrisë ngrohjen e klasave me rreth 3% kundrejt vitit 2017.

#### TP 3. Ofrimi i një ushqimi cilësor

Rritja e cilësisë së ushqimit të fëmijëve duke u bazuar në normativat dhe kaloritet sipas udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë.

Gjatë vitit 2018 janë realizuar fondet e parashikuara për sigurimin e ushqimit në masën 80% kundrejt planit.



# PROGRAMI

## ARSIMI PARAUNIVERSITAR

### OBJEKTIVI


**Përmirësimi i infrastrukturës në institucionet e arsimit parauniversitar**

**Realizimi i shpenzimeve :**  
 87% e vlerës së parashikuar  
 49,543 mijë lekë, 3% e buxhetit

### TREGUES performance

**TP 1. Rritja e efijecës së fondeve buxhetore**

Bashkia mbështet arsimin parauniversitar duke ndërtuar, mirëmbajtur institucionet e arsimit parauniversitar dhe të konvikteve të nxënësve dhe studentëve për të krijuar kushte sa më optimale për të përdorur me efektivitet financat e bashkisë.




# PROGRAMI

## MBROJTJA NGA ZJARRI DHE EMERGJENCAT CIVILE

### OBJEKTIVI

Përmirësimi i shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi

**Realizimi i shpenzimeve :**  
75% e vlerës së parashikuar  
27,667 mijë lekë, 1% e buxhetit



### TREGUES performance

#### TP 1. Rritja e efijecës së MZSH-së


Parandalimi me masat e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, ndërhyrja në shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore apo të shkaktuara nga dora e njeriut është pjesë e punës së MZSH. Plani është realizuar 100%.

Gjatë vitit 2018 janë ushtruar kontrolle në 489 raste në kategori të ndryshme objektesh e veprimtarish, ku është bërë 1 akt-bllokimi dhe janë lëshuar 89 çertifikata të MZSH-së. Është ndërhyrë në 231 raste prej të cilave 141 raste për zjarr dhe 90 raste për shpëtim, në aksidente. Të gjitha rastet e ndërhyjeve janë arritur në kohë edhe pse pajisjet janë të amortizuar.

#### TP 2. Rritja e efijecës së fondeve buxhetore

Bashkia duhet të mbulojë territorin e saj me shërbimin zjarrfikës me stacione të kompletuara me personel, automjete dhe pajisje zjarrfikëse. Për vitin 2018 Drejtoria e MZSH-se ka pasur 31 efektiva nga 60 efektive që duhet të jenë sipas kërkesave të ligjit. Edhe pse me mangësi në burime njerëzore dhe pajisje Stacioni i MZSH-së ka mbuluar të gjithë territorin e bashkisë për çdo ngjarje në raste zjarri ka evidentuar dhe vlerësuar dëmet.

Mbrojtja nga Zjarri dhe Emergjencat Civile  
Plan vs Fakt 2018 (në 000 Lekë)



# PROGRAMI

## UJITJA DHE KULLIMI

### OBJEKTIVI

Përmirësimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit

**Realizimi i shpenzimeve :**  
53% e vlerës së parashikuar  
92,180 mijë lekë, 5% e buxhetit




### TREGUES performance

TP 1. Vënia në funksion e veprave ujitëse dhe vaditëse

Gjatë vitit 2018 janë kryer investime në rehabilitimin e kanaleve ujitëse sekondare të rezervuarit të Gjançit dhe rikonstruksionin e veprave ujitëse në zonën jugperëndimore të Fushës së Korçës. Janë pastruar 160,000 metra linear kanale kulluese dhe janë vendosur 874 tombino betoni.

Gjatë vitit 2018 janë kryer investime në rehabilitimin e rrjetit të kanaleve ujitëse dhe skemat ujitëse në kanalet e Gjancit janë pastruar 180,000 metra linear kanale vaditëse.

Gjatë vitit 2018 ka pasur 21 raste rënie e zjarre me dëm dhe në cdo rast është bërë evidentimi dhe vlerësimi i tyre në kohë, në bashkëpunim me zyrën e emergjencave pranë Bashkisë.



# PROGRAMI

## ADMINISTRIMI I PYJEVE

### OBJEKTIVI

Zhvillim i qëndrueshëm i pyjeve dhe kullotave

**Realizimi i shpenzimeve :**  
16% e vlerës së parashikuar  
10,672 mijë lekë, 1% e buxhetit

### TREGUES performance


#### TP 1. Vjelja e të ardhurave nga kontratat

Deri sot fondi pyjor kullosor është menaxhuar në mënyrën më të mirë të mundshme, gjatë vitit 2018 janë rritur të ardhurat nga vjelja e kontratave të reja dhe kontratave ekzistuese dhe është rritur fondi pyjor nëpërmjet pyllëzime të reja dhe sistemime malore në masën 80% kundrejt planit.

#### TP 2. Mbarështrimi i pyjeve dhe kullotave

Planet e menaxhimit të pyjeve dhe kullotave janë të rëndësishme për rritjen e të ardhurave nga fondi pyjor por edhe për zgjerimin e këtij fondi.

Bashkia ka bashkëpunuar me Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit për të kryer inventarin e fondit pyjor dhe azhornimin e planit menaxhues.



# PROGRAMI

## UJI I PIJSHEM DHE KANALIZIMET

### OBJEKTIVI

Përmirësimi i ofrimit të ujit të pijshëm & kanalizimeve sanitare

### TREGUES performance

- TP 1. Popullata e mbuluar me shërbimin**

Është e vetmja bashki e cila e mbulon tërësisht territorin e saj me shërbim (100% - pjesën urbane).
- TP 2. Norma e arkëtimit të tarifave**

UK Korçë arkëton 82% të faturave të prera
- TP 3. Norma e mbulimit të kostove nga tarifat**

UK Korçë mbulon tërësisht kostot korente dhe pothuajse tërësisht edhe ato totale me të ardhurat nga tarifat e mbledhura.
- TP 4. Kohëzgjatja e ofrimit të ujit të pijshëm në 24 orë**

Bashkia Korçë është një nga bashkitë e pakta e cila ofron ujë të pijshëm 24 orë në pjesën urbane të saj.

